



29/05/2025

KËRKESË ANKIMORE

- Kërkues:** Aulon Kalaja, i biri i Ylli dhe i Rakipe, lindur në Krujë dhe banues në Fushë Krujë, lindur me 05/08/1989, me adresë Lagja Kastrioti, Fushë Krujë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr. Personal I90805078S, me nr telefoni 0692300035 dhe email aulonbejkalaja@gmail.com.
- Objekt:**
1. Kundërshtimi i Vendimit nr. 1327/2025 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse për Rezultatit në zonën zgjedhore Qarku Durrës, për subjektet zgjedhore për kandidatët për deputetë, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025”.
 2. Pavlefshmëria e rezultatit zgjedhor të zgjedhjeve të zhvilluara në datën 11 maj 2025 në zonën zgjedhore Qarku Durrës.
 3. Kontestim ndaj procesit të numërimit, zhvilluar në të gjitha KZAZ të qarkut Durrës me datë 12, 13, 14 dhe 15 maj 2025.
 4. Rinumerim të kutive të votimit në të gjitha KZAZ të qarkut Durrës.
- Baza Ligjore:** Nenet 123, 123/1, 124, 124/1, 126, 127, 138 e vijues i Kodi Zgjedhor
- Drejtuar:** Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me adresë Rruga Ibrahim Rugova nr. 4, Tiranë.

KËRKESË PROCEDURALE

E paraqesim kete kërkesë sot, me qellim që të zihet afati I ankimit, megjithate, kërkojmë nga ju, të na vendosni në dispozicion kohën e nevojshme për të analizuar pamjet filmike. Nese nga ana juaj do të pranohej në mënyrë të menjeherëshme hapja dhe rinumerimi I kutive, atehere, do të ishte e panevojshme që të na ngarkohet barra për të këqyrur cdo pamje filmike. Por duke qene se kjo është pjesë e disponimit tuaj përfundimtar, patjeter që kërkojmë nga ju, të na vendosni në dispozicion një kohe të arsyeshme për tu përgatitur para se të nisi shqyrtimin e ankesen.

Gjykojmë se pretendimet tona janë evidentuar dhe premisa e shkeljeve është vendorur, pasi është vendosur motivi I keqpasqyrimit e të dhenave.

Gjithashtu, rezervojmë të drejtën që deri në ditën e shqyrtimit të kërkesës, të shtojmë kërkimet dhe argumentat tona, gjithashtu deri në ate moment të paraqesim pretendime shtesë edhe sa I përket legjitimitetit, kjo nisur nga ngarkesa dhe mospasja e kohes fizike për të përmbyllur cdo argument.

Në datën 26.05.2025, kemi marrë dijeni për Vendimin nr. 1327, datë 24.05.2025 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse për Rezultatin në zonën zgjedhore Qarku Durrës, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025”. Duke mos qenë dakord me këtë vendim, për shkak se vlerësojmë se gjatë procesit të numerimit të rezultatit zgjedhor prej të cilit ka dalë ky vendim kanë ndodhur shkelje të ligjit, të cilat kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor, si dhe tërësia e shkeljeve të ligjit, të ndodhura në këtë zonë zgjedhore ka cënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që ka ndikuar në ndarjen e mandateve, sic do të provohet gjatë hetimit administrativ, po parashtrojmë këtë ankim me faktet, dispozitat ligjore dhe arsyetimin ligjor, si më poshtë vijon.

I. NË LIDHJE ME LEGJITIMIMIN E PALËS ANKUESE (NENI 123/1, PIKA 1, NENI 124, PIKAT 1 DHE 3, TË KODIT ZGJEDHOR

Kodi Zgjedhor, rregullon ankimin në rrugë administrative të vendimeve të komisioneve zgjedhore dhe të Komisionerit. E drejta e ankimit parashikohet në nenet 124, 124/1 dhe 126 të këtij Kodi.

Kodi Zgjedhor sa i përket legjitimitetit ben fjalë për parti politike, koalicion dhe kandidat të propozuar nga zgjedhësit. E megjithatë, nuk do të mund të pranohej argumentimi që këto janë palet e vetme të cilat legjitimohen aktivisht për të paraqitur një kërkesë ankimore. Kandidatet për deputet janë ndoshta pala me e interesuar dhe e prekur nga rezultati zgjedhor, e padyshim duhet të kene mundësinë të paraqesin kundërshtimet e tyre, të cilat do të duhet të konsiderohen dhe të merren në shqyrtim nga organi kompetent, KQZ në këtë rast.

Kandidatet për deputet preken jo vetem në mënyrë direkte, por mund të preken edhe në mënyrë indirekte nga rezultati zgjedhor. Si shembull të rastit të parë mund të marrim situatën ku votat e atij kandidat cenohen dhe keq pasyrohen në procesverbal, dhe si shembull të rastit të dytë mund të marrim situatën ku votat e kandidateve të tjerë keqpasqyrohen, apo i numerohen një kandidati të tretë, i cili eventualisht, në kete mënyrë grumbullon më teper vota se në realitet. Një rast tjetër është kur votat e partive respektive nuk pasqyrohen në mënyrë të rregullt dhe kjo ndikon në shperndarjen e mandateve midis partive politike.

Për sa kohë ndryshimet në ligjin zgjedhor e kthyen kandidatin për deputet në një subjekt aktiv, i cili grumbullon vota parapëlqyese, dhe po në bazë të ketyre votave, ai do të renditet në listen fituese, padyshim që ai legjitimohet ti drejtohet KQZ me kërkesa lidhur me procesin zgjedhor.

Duke qenë se Tabela Përmbledhëse e Rezultatit të Zonës Zgjedhore të Qarkut Durrës objekt i kësaj kërkesë ankimore është për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë si dhe duke qenë se ankuesi është kandidat për deputet i Qarkut Durrës, atëherë ai konsiderohet subjekt i interesuar e për rrjedhojë legjitimohet për të ankimuar vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve të dalë në zbatim të nenit 123 të K.Zgjedhor.

Gjykata Kushtetuese, që prej vitit 2002 ka vendosur dhe sanksionuar se neni 42 i Kushtetutes, sa i përket procesit të rregullt ligjor, duhet dhe shtrihet edhe në procese të tjera ligjore vec atyre gjyqësore, konkretisht edhe për proceset administrative sikurse është rasti.

Do të ftonim KQZ që të interpretonte legjitimitetin e palës së interesuar jo vetem nën frymën e Kodit Zgjedhor, por mbi të gjitha nën frymën e Kodit të Procedurave Administrative ashtu sikurse edhe bazuar në legjitimitetin e së drejtës civile apo së drejtës procedurale civile.

Më tej, KQZ do të duhet të kete në konsiderate legjitimitetin në gjykimin kushtetues të individit, bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, i cili parashikon se për shkelje kushtetuese të së drejtës për tu zgjedhur mund të ankimohen ne Gjykatën Kushtetuese aktet publike, sikurse eshte cdo akt që prodhon KQZ i cili cenon të drejtën për tu zgjedhur.

Me tej, KQZ do të duhet të mbajë në vemendje edhe legjitimitetin në GjEDNj për të mbrojtur të drejtën për tu zgjedhur dhe për zgjedhje të lira, ate cka GjEDNj e përkufizon viktime.

Të gjitha keto duhet të detyrojnë KQZ që të interpretojë në mënyrë të zgjeruar Kodin Zgjedhor për ceshtjen e legjitimitetit aktiv të subjekteve që paraqesin ankim.

II. NË LIDHJE ME AFATIN E PARAQITJES SË ANKIMIT (NENI 152, PIKA 2 E KODIT ZGJEDHOR)

Vendimi i Komisionerit është marrë me date 24/05/2025. Sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor, subjektet e legjitimuara mund të paraqesin ankim brenda 5 diteve nga e nesermja e publikimit të vendimit. Për rrjedhoje, kërkesa ankimore është paraqitur brenda afatit të përcaktuar.

III. RRETHANAT E FAKTIT

Me datë 12 maj, nisi numerimi i votave në KZAZ të qarkut Durrës. Nga ana e vezhguesve, në KZAZ nr. 20, herë pas herë, vereheshin mosperputhje midis shenimeve të tyre dhe shumatorës së votave të nxjerrë nga ana e grupeve të numerimit, me 1 deri në 6 vota, si në votat e partive politike

ashtu sikurse edhe në votat preferenciale të kandidatëve për deputet. Më konkretisht, rezultoni disa kandidat me më shumë vota.

Kur vendosej në dije kjo mospërputhje, grupi i numerimit, numeronte perseri vetem fletat, pa treguar shenjen preferenciale publikisht, me anë të kameras ose jo. Në dy raste, që nga kandidati për deputet i qarkut të Durrësit, z. Aulon Kalaja u kembenguli që votat e kandidateve që rezultoni me më tepër vota të rinumeroheshin duke i treguar në ekran, rezultoi se në njerin rast 2 vota i ishin kaluar një kandidati tjetër, jo atij të votuar. Ky incident ka ndodhur në tavolinën nr. 1 të numerimit, me kutinë 1283, fakt lehtësisht i provueshëm me anë të këqyrjes së pamjeve filmike që KQZ disponon. Në rastin e dytë, 4 vota i kishin kaluar perseri një kandidati tjetër dhe jo atij të votuar, incident ky i ndodhur në tavolinën numer 3 të numerimit me kutinë 1264.

Marrë parasysh sa më sipër, duke qene se nga ana e vezhgueseve janë konstatuar parregullsi në shumicën e kutive dhe gjithashtu i njeiti raportim ka ardhur edhe nga KZAZ e tjera të Qarkut Durrës, na u krijuar dyshimi i arsyeshëm që këto mospërputhje nuk kanë qenë të rastesishme dhe mospërputhje mund të kete edhe në kuti që vezhguesit nuk kanë arritur të mbajnë shenim cdo vote, kjo edhe pertej KZAZ nr. 20.

Nisur nga kjo indicie, u kërkua vendosja në dispozicion të të gjithë pamjeve filmike të KZAZ Durrës. Pamje të cilat na u vendosen në dispozicion, por me një vonesë të konsiderueshme. Nga këqyrja e tyre, u konfirmuan dyshimet sa i përket kutive të ndryshme të KZAZ nr. 20, por gjithashtu, u verejtën problematika edhe në KZAZ të tjera të qarkut Durrës, si KZAZ nr. 21.

Duke qene se pamjet filmike janë venë në dispozicion, vonë mbremjen e dates 24.05.2025, kemi patur më pak se 4 ditë për ti këqyru, dhe sikurse është e vetekuptueshme nuk kemi arritur ti analizojmë të gjitha pamjet, por vetem një pjesë të KZAZ nr. 21 dhe një pjesë fare të vogël të pamjeve të KZAZ nr. 20. Nga ajo analizë ka rezultuar se deri më tani, me aq sa kemi mundur të analizojmë, keto janë disa nga problematikat lidhur me rezultatin zgjedhor:

1. Kutia 1352, një kandidat rezulton me **4 vota** preferenciale nderkohe që në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **0 vota**. Në po kete kuti një kandidat rezulton me **31 vota** preferenciale nderkohe që në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **36 vota**.
2. Kutia 1358, një kandidat rezulton me **10 vota** preferenciale nderkohe që në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **7 vota**. Një kandidate rezulton me **11 vota** preferenciale nderkohe që në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **10 vota**. Në po kete kuti një kandidat rezulton me **31 vota** preferenciale nderkohe që në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **35 vota**.
3. Kutia 1361, një kandidat rezulton me **4 vota** preferenciale nderkohe që në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **2 vota**. Një kandidati rezulton me **3 vota** preferenciale nderkohe që në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **2 vota**. Një kandidate rezulton me **1 votë** preferenciale nderkohe që në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **0 vota**. Një kandidati rezulton me **20 vota** preferenciale nderkohe që në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **25 vota**.

4. Kutia 1347, një kandidat rezulton me **3 vota** preferenciale nderkohe që në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **2 vota**. Në po kete kuti një kandidat rezulton me **17 vota** preferenciale nderkohe që në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **18 vota**.
5. Kutia 1362, një candidate rezulton me **14 vota** preferenciale nderkohe që në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **11 vota**. Në po kete kuti një kandidat rezulton me **12 vota** preferenciale nderkohe që në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **15 vota**.
6. Kutia 1355, një kandidat rezulton me **5 vota** preferenciale nderkohe që në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **4 vota**.
7. Kutia 1359, një kandidat rezulton me **3 vota** preferenciale nderkohe që në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **2 vota**. Një candidate rezulton me **10 vota** preferenciale nderkohe që në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **9 vota**. Një kandidat rezulton me **1 vote** preferenciale nderkohe që në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **0 vota**.
8. Kutia 1364/01, një candidate rezulton me **4 vota** preferenciale nderkohe që në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **3 vota**. Një candidate rezulton me **1 votë** preferenciale nderkohe që në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **0 vota**. Një kandidat rezulton me **14 vota** preferenciale nderkohe që në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **15 vota**.
9. Kutia 1363, një candidate rezulton me **1 votë** preferenciale nderkohe që në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **0 vota**. Në po kete kuti një kandidat rezulton me **12 vota** preferenciale nderkohe që në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **11 vota**.
10. Kutia 1357/1, një candidate rezulton me **34 vota** preferenciale nderkohe që në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **33 vota**. Në po kete kuti një kandidat rezulton me **6 vota** preferenciale nderkohe që në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **7 vota**.
11. Kutia 1349/1 një kandidat rezulton me **9 vota** preferenciale nderkohe që në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **7 vota**. Në po kete kuti një kandidat rezulton me **9 vota** preferenciale nderkohe që në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **4 vota**. Në po kete kuti një kandidat rezulton me **4 vota** preferenciale nderkohe që në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **3 vota**.
12. Kutia 1348, një kandidat rezulton me **5 vota** preferenciale nderkohe që në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **6 vota**. Në po kete kuti një kandidat rezulton me **10 vota** preferenciale nderkohe që në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **9 vota**.
13. Kutia 1330, një candidate rezulton me **4 vota** preferenciale nderkohe që në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **3 vota**. Në po kete kuti një kandidat rezulton me **8 vota** preferenciale nderkohe që në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **6 vota**. një candidate rezulton me **34 vota** preferenciale nderkohe që në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **33 vota**.

14. Kutia 1344, një kandidat rezulton me **2 vota** preferenciale nderkohe që në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **1 vote**. Në po kete kuti një kandidat rezulton me **3 vota** preferenciale nderkohe që në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **2 vota**.
15. Kutia 1300/01, një kandidat rezulton me **2 vota** preferenciale nderkohe që në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **1 vote**. Në po kete kuti një kandidat rezulton me **3 vota** preferenciale nderkohe që në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **2 vota**.
16. Kutia 1321 një kandidat figuron me **6 vota** më teper në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor.
17. Kutia 1298 një kandidate figuron me **6 vota** më teper në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor dhe një kandidat me 4 më teper.
18. Kutia 1266 një kandidat figuron me **3 vota** më teper në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor.
19. Kutia 1282 një kandidate figuron me **3 vota** më teper në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor.
20. Kutia 1286 nje kandidate figuron me **3 vota** më teper në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor.
21. Kutia 1300 një kandidate figuron me **3 vota** më teper në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor.
22. Kutia 1281 një kandidate figuron me **2 vota** më teper në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor.
23. Kutia 1298/1 një kandidate figuron me **2 vota** më teper në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor.
24. Kutia 1303/1 një kandidat figuron me **2 vota** më teper në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor.
25. Kutia 1320 një kandidat figuron me **2 vota** më teper në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor.
26. Kutia 1298 një kandidat figuron me **2 vota** më pak në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor.
27. Kutia 1320 një kandidat figuron me **3 vota** më pak në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor .
28. Kutia 1322 një kandidat figuron me **4 vota** më pak në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor.
29. Kutia 1321 një kandidat rezulton me **38 vota** preferenciale nderkohe që në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **41 vota** dhe një kandidat rezulton me **25 vota** preferenciale nderkohe që në në tabelen përmbledhese të rezultatit zgjedhor figuron me **28 vota**.

Gjithashtu, mospërputhje janë evidentuar në kutitë **1254, 1310, 1258, 1296, 1307, 1298/1, 1295/2, 1300/1.**

IV. ANALIZA LIGJORE

NË LIDHJE ME THEMELIN E KËRKIMEVE

Sikurse u analizua më sipër, në të gjithë procesin e numerimit dhe të pasqyrimin të rezultatin zgjedhor në Qarkun e Durrësit ka patur problematike dhe shkelje shumë evidente. Shkelje që janë vënë në dukje nga ana jonë pas këqyrjes së pamjeve filmike. Duke qenë se afati që kemi patur në dispozicion ka qenë absolutisht dhe objektivistisht shumë i shkurtër, do të kërkonim nga ju që të na jepni kohën e mjaftueshme të këqyrjes edhe pamjet e tjera, në mënyrë që të mund të paraqesim pretendimet tona në mënyrë sa më të plotë, përpara se kërkesa jonë të shqyrtohet nga ana juaj.

Nëse kërkesa jonë shqyrtohet brenda ditëve të ardhshme, do të cenohej parimi i kontradiktoritetit dhe i procesit të rregullt ligjor dhe do të ishim në pamundësi të argumentojmë të gjithë shkeljet e evidentuara.

E megjithatë, marrë parasysh, shkeljet e cituara, gjykojmë se krijohet një premise e arsyeshme për të kërkuar nga ju që në bazë të nenit 138 të Kodit Zgjedhor të këqyrni pamjet filmike ashtu sikurse materialit zgjedhor. Gjithashtu, bazuar në po atë premisë, e gjemë me vend, të kërkojmë nga ju, të realizoni rinumerimin e kutive të votimit të Qarkut Durrës.

Rezultati zgjedhor i miratuar nga Komisioneri, nuk pasqyron rezultatin real dhe as vullnetin real të zgjedhësve.

V. NË LIDHJE ME PROVAT QË KËRKOJMË TË MERREN


Provat e nevojshme për të trajtuar kërkesën tonë ankimore, ndodhen të gjitha pranë KQZ, nga ku dhe ne vetë kemi marrë pamjet filmike. Mjafton që ti analizoni ato me kujdesin e duhur.

Në mbështetje të nenit 45 të Kushtetutës së Shqipërisë, nenit 3, Protokollit 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenet 143, 160 dhe 161, të Kodit Zgjedhor,

Përfundimisht kërkojmë,

1. Pranimin e kërkesës ankimore.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 1327/2025 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse për Rezultatin në zonën zgjedhore Qarku Durrës, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025”.
3. Kontestim ndaj procesit të numërimit, zhvilluar në të gjitha KZAZ të qarkut Durrës me datë 12, 13, 14 dhe 15 maj 2025, sa i përket votes preferenciale të kandidatëve të Partisë Demokratike.
4. Rinumerim të kutive të votimit.

KÄRKUES
AULON KALAJA

A handwritten signature in blue ink, consisting of several overlapping loops and a long horizontal stroke extending to the right.

